

**AKT THEMELIMI DHE STATUT
PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE
“ENVIRONMENTAL ASSESSMENT AND MONITORING” SH.P.K.**

Sot me date 02/02/2020 ky Statut u perpilua nga ortakut themelues:

1. Ornela Shoshi, e bija i Paulin, lindur ne Tirane me date 14/10/1982, banuese ne Rr. “Kongresi i Tiranes”, nr. 6, Ap. 24, Tirane, me nr. Personal I26014088F, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

E quajtur me poshte ortakut i vetem themelues, e cila ne perputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar, krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar si vijon:

KREU I

NENI 1

FORMA

Ortakut i mesiperm krijojne nje Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

NENI 2

EMRI I SHOQERISE

Emri i shoqerise do te jete “ENVIRONMENTAL ASSESSMENT AND MONITORING” SH.P.K. dhe emri tregtar i saj do te jete “EAM” SH.P.K.



NENI 3

SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes me adrese Rr. "Shyqyri Berxolli", pallati Inter-Co Sat, Seksioni B, apartamenti 2/2. Shoqeria ka te drejte qe me vendim te ortakut te shoqerise mund te hape dege, zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete kohezgjatje te papercaktuar. Si date fillestare merret data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria ka si objekt kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një kompani me përgjegjësi të kufizuar mund të kryejë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, brenda dhe jashtë territorit të saj, përfshirë por pa u kufizuar në:

Te zhvilloje studime mjedisore, studime te vleresimit te ndikimit ne mjedis, si dhe vleresime strategjike mjedisore. Te zhvilloje procedura per lejet e mjedisit. Te zhvilloje studime fizibiliteti, studime gjeologjohinjerike, hidrologjike, socioekonomike, dhe gjithfare studimesh qe kerkohen ne kuader te studimit te fizibilitetit. Te jape konsulence mjedisore dhe jo vetem, subjektive private dhe shtetore. Te kryeje gjithfare sherbimesh qe kane te bejne me fushen e mjedisit dhe jo vetem, perfshire edhe procedurat administrative per pajisjen me leje apo licenca, per kliente private dhe shtetore. Te realizoje studime dhe monitorime per biodiversitetin, si dhe te realizoje dhe zbatoje projekte per mbrojtjen e biodiversitetit. Te realizoje monitorim mjedisor per shkarkimet ne mjedis dhe ndotjen e mjedisit. Te trajnoje subjektet private dhe shtetore mbi parandalimin e ndotjes, risku mjedis, rehabilitimin e mjedisit nga ndotja. Te kryeje vleresimin e demit mjedisor. Te siguroje asistence ligjore per ceshtjet qe lidhen me mjedisin. Te hartoje e te zbatoje projekte per pastrimin dhe rehabilitimin e zonave te ndotura. Te asistojte dhe te kryeje administrimin e mbetjeve. Te mbikqyre dhe auditoje zbatimin e projekteve ne fushen e mbrojtjes se mjedisit. Te asistojte kliente private dhe shtetore per zhvillimin ne fushen e turizmit dhe bujqesise.

Te kryeje monitorime te gjendjes se mjedisit dhe komponenteve te saj si mjedis ujor, ajrin, biodiversitetin, pyjet dhe tokes, duke perfshire edhe shkarkimet e zhurmes dhe vibrimet. Te zhvilloje analiza laboratorike per matjen e parametrave te cilesise se ujrave siperfaqesore, ujit te

pijshe, tokes dhe ajrit, si dhe shkarkimeve te te gjitha llojeve te industrise duke perfshire edhe shkarkimet e zhurmes dhe vibrimet, te monitoroje parametrat mjedisore te qyteteve si ajri, zhurmat etj. Te jape konsulece ne fushen e mjedisit, turizmit, bujqesise, shendetin dhe sugurine ne pune dhe jo vetem. Te hartoje dhe zbatoje projekte per trajtimin e ujrave te ndotura, industriale, ujrave bregdetare etj. Te ofroje konsulence ne fushen e GIS etj. Ofron sherbime ne pajisjen dhe implementimin e sistemeve ISO 14001, 9001, EMAS (SEMA), ECO LABEL (EKO ETIKETA)etj.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (nje qind mije) leke, i ndare ne 1 kuota.

NENI 7

KONTRIBUTET

1. Ortaku i vetem themelues Ornela Shoshi zoteron nje kuote me perqindje 100% dhe vlere te pergjithshme 100 000 leke.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para dhe ne natyre (pasuri te luajtshme apo te paluajtshme dhe te drejta te vleresueshme ne para).

NENI 8

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakut themelues ne masen 100%.

NENI 9

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR



Kuotat e kapitalit te shoqerise mund te transferohen me ane aktesh mes te gjalleve dhe me trashegimi. Transferimi i kuotave te kapitalit te shoqerise nuk i nenshtrohet asnje lloj kufizimi, ne qofte se ndodh ne rast vdekjeje.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 10

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve organizon, drejton dhe kontrollon gjithe aktivitetin e shoqerise. Ortaku perballon humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij.

NENI 11

DREJTIMI I SHOQERISE

Organi me i larte drejtues i shoqerise do te jete asambleja e ortakeve. Asambleja e ortakeve mblidhet si rregull dy here ne vit, si dhe sa here qe gjykohet e arsyeshme.

NENI 12

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

1. Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:
 - a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;



- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
 3. Asambleja e ortakeve vendos për çdo çështje që ajo gjykon të arsyeshme.

NENI 13

ADMINISTRATORI

Shoqëria do të administrohet nga administratori **Ornela SHOSHI** e bija i Paulin, lindur në Tiranë me datë 14/10/1982, banuese në Rr. "Kongresi i Tiranës", nr. 6, Ap. 24, Tiranë, me nr. Personal I26014088F, madhore e me zotësi të plote juridike për të vepruar.

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqërisë emerohet nga asambleja e ortakeve, i cili përgjigjet për zbatimin e vendimeve të asamblese së ortakeve. Afati i emerimit në detyrë të administratorit do të jetë 5 vjet.

Administratori ka këto kompetenca:

- a) Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Të përpilojë dhe nënshkruajë kontratat dhe aktet juridike që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë.
- c) Të hapin llogari rrjedhese bankare pranë bankave shqiptare ose të huaja.
- d) Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretet.
- e) Të emerojnë nëpunës të rangjeve të ndryshme për veprime të veçanta teknike ose për një kategori të caktuar veprimesh.

- f) Te përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- g) Te kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- h) Te përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- i) Te krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- j) Te kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- k) Te raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- l) Te beje gjithçka tjetër që konsideron të dobishme dhe që është në përputhje me formën e këtij Statuti e të Aktit Themelues si dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, për të arritur qëllimin dhe objektin e shoqërisë.

KREU V

LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

NENI 15

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabël që kërkon legjislacioni në fuqi edhe këto libra :

- 1- Libri i vendimeve të ortakut.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të Administratorit
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të organit sindikal.

NENI 16

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI KONTABEL

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i parë financiar mund të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë si person juridik dhe do të përfundojë me 31 Dhjetor 2020. Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e veçanta të hartuara



nga administratori miratohen nga asambleja e ortakeve. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 17

AKTIVITETI FINANCIAR

Ne çdo mbyllje çdo viti financiar administratori ben inventarin dhe llogarine vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin, si dhe hartohet nje raport me shkrim Bilancit i bashkengjiten:

- a. Nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria,
- b. Nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria,

Raporti i administratoreve perfshi gjendjen gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e mundshme qe jane zhvilluar nga data e mbylljes se vitit financiar deri ne ditën qe eshte hartuar ky raport.

Dokumentet vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar, te pakten nje muaj para mbledhjes se asamblese.

NENI 18

FITIMET

Fitime neto te shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat e te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise, detyrimet fiskale, shoqerore, demet, amortizimet, etj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi.

Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullmi i çdo fondi te veçante caktohet nga ortaku i vetem ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Ne perputhje me ligjin nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet menjane nje shume me vlere 1/20 e cila destinohet per krijimin e nje fondi "rezerve e domosdoshme".

NENI 19

PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria priset me kalimin e afatit te caktuar ne statut dhe per arsye te parashikuara ne ligj. Shoqeria priset perpara afatit me vendim te Asamblese ortakeve.



NENI 20

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin, si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit.

NENI 21

Kur shoqeria prishet ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit. Prishja e shoqerise eshte me pasoje ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregtar.

NENI 22

Per te perfunduar procesin e likuidimit, Asambleja e ortakeve emerone nje ose disa persona si likujdues te cilet perfaqesojne shoqerise. Likuiduesi perpilon bilancin financiar likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

NENI 23

Ne perfundim te mbylljes se likujdimit, ortaku i vetem vendos per bilancin financiar perfundimtar per aktin e rregullshmerise, per admimstrimin e tij nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te likuiduesit, si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga Ortaku i vetem.

NENI 24

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, u kthehen pronareve.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena pasi te jene likujduar kreditoret.

NENI 25

DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se



Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e vecante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punonjesit.

Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Kur mosmarreveshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e shkalles se pare Tirane.

NENI 26

Ky statut firmoset me vullnetin e lire te ortakut themelues.

ORTAK THEMELUES

ORNELA SHOSHI

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Ornela Shoshi', with a stylized flourish below it.